



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 114/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 14.06.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **27 qershor 2024 (e enjte), me fillim në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e muajit maj 2024, mbajtur më datë 03 qershor 2024.
2. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2023/2024.
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë.
4. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje.
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026.
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira financiare nga investimet kapitale.
8. Pyetje dhe përgjigje

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 113/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 14.06.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **13 qershor 2024** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2023/2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
3. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
4. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
5. Shqyrtimi i Draft- Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024 – 2026.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ridestinim të mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E V E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 03 QERSHOR, 2024

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:20**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Fakele Dushi, Fatmire Cecelia, Jeton Gjaka, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Mek Selaci, Alban Bajrami, Leonora Gërguri dhe Spasoje Stefanoviç.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetarja e komunës znj. Hava Rruka-Mlinku, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Kuvendi, në fillim të punimeve të mbledhjes së rregullt, nderoi me një minutë heshtej të ndjerin z. Agim Vatovci, për jetën dhe veprën e tij.

z. Mentor Ferizi, bazuar në vendimin e KQZ-së, para kuvendit dhe betimin duke u bërë anëtar i kuvendit me të drejta të plota.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- në fillim të mbledhjes njoftoi kuvendin se pas konsultimeve që ka pasur me MAPL-në dhe zyrtarët kompetent komunalë, dhe me qëllim të heqjes së çdo dileme edhe për sa i takon votimit, propozoi të futet në rend të ditës Propozim – vendimi për pagesën e shujtave ditore, për zyrtarë të administratës së komunës.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- duke iu adresuar Kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: fillimisht dua t'i uroj drejtorët e ri për pozitat e reja dhe t'ju uroj punë të mbarë, por kam një pyetje për ta:

A e dini se për çfarë periudhe jeni emëruar në këto pozita, për disa ditë, për disa javë apo deri në rregullimin e rrugës Vushtrri-Prishtinë?!

I nderuar kryetar, se nuk ju përgjigjeni kuvendit dhe anëtarëve të kuvendit e kemi parë, por ju nuk po i përgjigjeni as qytetarëve të Vushtrrisë dhe as mediave. Ne këtu, në këtë foltore, shumë herë ju kemi pyetur se pse po ndodhin gjithë këto shkarkime në komunën tonë, çfarë po fshihet pas gjithë këtyre ndërrimeve, por ju kryetar asnjëherë nuk jeni përgjigjur. Po e cilësoni vetën si trajner të futbollit, duke thënë që lojtaret e dobët duhet të largohen nga fusha, por mos harroni që për lojë të dobët në fushë ndërrohet edhe trajneri, e siç po duket, komunës sonë pashmangshëm do t'i ndërrohet trajneri. E bëni komunën klub futbollit dhe harroni që Vushtrria ka me të vërtetë një klub të futbollit i cili po përballlet me shumë vështirësi, por kjo nuk ju bënë përshtypje. U munduam të gjithë ta ngrisnim klubin tonë të zemrës dhe për një kohë shumë të shkurtër arritëm që ta sjellim klubin në barazh për Superligë, dhe tani erdhët ju Kryetar dhe e sollët klubin përsëri në një pozitë shumë të rëndë, ku as nuk kanë financa, as nuk kanë përkujdesje dhe as nuk kanë mundësi t'ju takojnë kurrë, sepse nuk i prisni. A keni ndonjë shpjegim kryetar?, po pyes për klubin e futbollit sepse për këtë klubin ku ju jeni trajner shpjegimin e marrim nga draft – raporti i Auditorit. Të dashur qytetar të Vushtrrisë, janë hiç ma pak se 27 të gjetura në draft – raportin e auditorit të jashtëm, kjo është gjendja më e keqe e komunës sonë në tërë historinë e saj, në asnjë qeverisje të mëhershme nuk ka pasur kaq shumë të gjetura. Kryetar, nëse mendoni që me ndërrimin e drejtorëve mund ta justifikoni vetën e keni shumë gabim, sepse, mos harroni, se kur ekipi përformon dobët ndërrohet edhe trajneri. Kam edhe një çështje Kryetar, komuna jonë ka probleme me paga të punëtorëve të ndërmarrjes publike dhe me shumë gjasë punëtorët për shkak të planifikimit tuaj të dobët do të mbesin pa paga në muajt e fundit të vitit, ndërsa në anën tjetër ju shohim duke shpërndarë shujta, si i keni shpërndarë këto shujta Kryetar, vetëm për një muaj, apo do vazhdoni prapë t'i shpërndani edhe pse edhe këtu keni bërë dallime duke selektuar punëtorët dhe duke mos i përfshirë në shujta punëtorët e sigurimit dhe të pastrimit. A keni ndonjë shpjegim kryetar? Në fund tha se raporti i auditorit ka konstatuar më shumë 20 të gjetura, dhe kjo dëshmon më së mirë për gjendje se si po qeveriset në Vushtrri. Po ashtu pyet se në çfarë forma janë paguar shujta për punëtorët e N.P.L. “Përparimi” sepse siç dihet kjo kompani gjendet në gjendje jo të mirë financiare, andaj kjo formë e ndarjes është përpos jo-gjithëpërfshirëse edhe vështirë e realizueshme, dhe si rezultat i keqplanifikimit me shumë gjasë punëtorët e kësaj kompanie në fund të vitit do të mbesin pa paga.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-vlerësoi se muaji maj ka qenë i karakterizuar me ndryshime shumë të mëdha në qeverisjen lokale të Vushtrrisë. Dhe për vetëm në nëntë drejtori komunale, në një periudhë më pak se tre vjeçare janë ndërruar 24 drejtorë dhe ushtruesë të detyrës, dhe në fund kemi edhe shkarkimin e nënkryetarit të komunës. Qytetarët dhe anëtarët e kuvendit janë tërësisht të painformuar për këto ndërrime kadrovike, dhe kjo çështje bënë që kryetari i komunës të shkel kreun e shtatë neni 51 të statutit të Komunës së Vushtrrisë i cili thotë: *Kryetari i komunës njofton Kuvendin e komunës në rast të ndryshimit të emërimit të ri të ndonjë drejtori apo drejtorie*. Prandaj kjo pikë e statutit nuk është duke u respektuar nga ana e kryetarit të komunës. Në vazhdim ai për të bërë të qartë para anëtarëve të kuvendit lexoj emrat e drejtorëve të dejetorive komunale të cialt janë ndërruar gjatë periudhës trevjeçare qeverisëse por edhe drejtorëve aktual. Në këtë konteskt ai vlerësoi se për këto ndryshime të shpeshta e të shumta qytetari i Vushtrrisë është i shqetsuar se çfarë në fakt është duke ndodhur. Mamdje shtoi se mujin maj 2024 e kanë karakterizuar edhe vizitat e shumta të kryetarit të komunës jashtë vendit dhe pyeti se cila është natyra e këtyre vizitave dhe cialt janë përfitimet e komunës nga këto vizita.

Edona Gashi, anëtare e kuvendit- duke iu adresuar Kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: Sot dua të trajtoj çështjen e kompanisë Speex e cila tashmë e sa vite operon në komunën tonë duke punësuar shumë të rinj e të reja. Me 26 Tetor 2021 kryetari Xhafer Tahiri pati nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancimin e komunës (50% të shumës së paguar) për ndjekjen e kurseve në gjuhën Gjermane dhe Frënge në Speex, për 200 të rinj Vushtrias. Qëllimi i këtij subvencionimi ishte punësimi i të rinjve dhe të rejave të qytetit dhe ne kishim besimin se do të ndihmonim qytetarët tanë të zhvillonin aftësitë e tyre. Pastaj, me 10 Mars 2023, kryetari Idrizi e vazhdoi po këtë kontratë, me 50% bashkëfinancim të cilën nuk po e përmbushë. Deri sot, nuk kemi parë rimbursime të premtuara dhe komuna po jep arsye të pabaza, si shtyrja e buxhetit, duke mashtruar qytetarët. Kjo situatë është e papranueshme dhe kërkojmë që të mbani përgjegjësi dhe të përmbushni premtimet dhe obligimet e juaja. Po ashtu, kërkoj nga kryetari që të na njoftoi lidhur me këtë marrëveshje, ku ka ngecur marrëveshja dhe pse të rinjtë nuk po e marrin rimbursimin e premtuar. Ne, kryetar, nuk e kemi plan të ndalemi dhe do të vazhdojmë të luftojmë për të drejtat e qytetarëve dhe për një qeverisje transparente të cilën ju nuk e keni e me të cilën edhe po krenoheni".

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-pasi i përshëndeti të pranishmit në adresimin e tij para kuvendit njoftoi mes të tjerash se sa i përket informimit për ndërrimin e drejtorëve komunal, nuk ka pasur hapësirë të njoftoj kuvendin sepse nuk pasur mbledhje të kuvendit që është mbajtur gjatë kësaj periudhe kohore. Në këtë kontekst shtoi se, atë që ka thënë para mediave mbetet prapa saj, sepse ka qenë kërkesë e këtyre drejtorëve që të lirohen nga detyra për shkak të angazhimeve tjera të tyre, dhe edhe pas këtyre ndryshimeve qeveria është duke vepruar normalisht pa ndonjë problem. Lidhur me draft-raportin e auditorit të përgjithshëm deklaroi se ai do të diskutohet në kuvend kur të finalizohet, dhe shtoi se ai që e ka publikuar këtë raport ka bërë shkelje, sepse në këtë stad nuk ka pasur të drejt që ai të publikohet. Për këtë vlerësoi se është akoma herët të diskutohet kjo çështje, sepse edhe vitin e kaluar ka pasur të gjetur por pasi është plotësuar dhe është ndryshuar në aspektin pozitiv, si do që të jetë ky raport do të diskutohet në kuvend pasi që ai të finalizohet. Sa i përket klubit të futbollit, tha se ka mbështetur këtë klub prej se ka ardhur në krye të komunës dhe për këtë janë edhe dëshmitë, ky klub ka problemet e tij por shumë shpejt mendojmë se do ta ndihmojmë për ta ringjallur, përmes donatorëve, përkatësisht përmes të ardhurve nga tatimi në fitim i bizneseve që veç se këto biznese na kanë ofruar asistencën e tyre, në bazë të ligjit për sponzorë, ashtu siç është zgjidhur çështja me klubin e Hendbollit. Tutje lidhur me ndarjen e shujtave për punëtorët e Ndërmarrjes Përparimi ceku se janë tri kategori, dhe kjo ka ndodhur për t'i stimuluar këta punëtorë të vyer, pasi që komuna i ka dhënë shërbime kësaj kompanie, duke zgjeruar gamen e shërbimeve sepse kësaj kompanie i janë dhënë edhe mirëmbajtja e ndriçimit publik. Lidhur me vizitat jashtë shtetit, njoftoi se të gjitha vizitat kanë qenë zyrtare me karakter pune me theks për të hulumtuar investitor. Vizita në Malin e Zi, ka qenë sepse komuna jonë është bërë pjesë e Unionit të Komunave Shqiptare me seli në Tiranë. Vizita në Gjermani është bërë me dy asamblistët e kuvendit z. Agron Përçuku dhe z. Arlind Gogolli, ka qenë një vizitë e frytshme dhe e suksesshme, takimi ka qenë me një kompani Kosovare në Gjermani, e cila prodhon dyer kundër zjarrit dhe e njëjta ka aplikuar për leje në Komunën e Vushtrrisë, për hapjen e një fabrike të tillë në Komunën e Vushtrrisë që përfshinë investime në vlerë prej 5 milion euro. Lidhur me pyetjen e anëtares së kuvendit znj. Gashi, për subvencionet për Speex, njoftoi se është shqetësim i bazuar, por me të hyrat e bartura të cilat akoma nuk janë lëshuar mendon se me të njëjtat do të mbulohen këto obligime të cilat i kemi marr mbi vete, më këtë rast jemi duke i paguar edhe 11 profile profesionale me qendër në Mitrovicë, të cilat janë të kërkuara nga ana e tregut. Në fund tha se, ky vit është ndër vitet më sfiduese në aspektin financiar, por beson se edhe me ndihmën e donacioneve nga ana e disa ministrive do të mbulohet deficitin financiar i Komunës së Vushtrrisë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se, konstatimi i kryetarit të komunës, se nuk ka pasur mbledhje të kuvendit për të njoftuar për ndërrimin e drejtorëve komunal, është i paqëndrueshëm, sepse ndërrime ka pasur edhe më herët por asnjëherë nuk pasur njoftim për kuvend dhe opinionin publik, ndërsa në media kryetari ka dhënë një sqarim se drejtoresha e Urbanizmit është liruar nga pozita për shkak të udhëtimit, gjë e cila është e pa vërtetë, sepse kjo e fundit është zyrtare në DUMM në Vushtrri dhe e njëjta udhëton nga Prishtina në Vushtrri. Lidhur me ndihmën e klubit të futbollit, sqaroi opinionin se ka qenë premtim që nga ardhja në pushtet e kryetarit për ofrimin e 30% nga subvencionet nga bizneset, por edhe pas tri viteve nuk ka asnjë përmbushje të këtij premtimi dhe në ndërkohë klubi është duke shkuar drejt shkatërrimit në aspektin financiar. Ndarja e shujtave për punëtorët e Përparimit është dashur ose të bëhet për të gjithë ose nuk është dashur të bëhen dallime. Në fund lidhur me sfidat me limitet buxhetore vlerësoi se nuk kemi të bëjmë me sfida buxhetore por me keqmenaxhim dhe keqshfrytëzim të buxhetit të komunës. Krejt në fund pyeti se kush është drejtor i Drejtorisë së Prokurimit Publik.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se, kryetari i komunës prap bëri shkelje të statutit të komunës, duke mos në treguar se kush janë drejtorët e drejtorive komunale që i ka emëruar. Andaj kërkoj nga kryetari i komunës që ndryshimet në drejtoritë komunale që i ka bërë, të njoftoi emër për emër.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-sqaroi se statuti i komunës nuk përcakton se si të njoftohet kuvend, sepse emërimi i drejtorëve është kompetencë e kryetarit të komunës dhe me që është kështu ai do të njoftoi kuvendin me shkrim, për të gjitha ndryshimet që janë bërë në drejtoritë komunale. Lidhur me Drejtorinë e Urbanizmit ceku se z. Nexhat Merovci, nuk është në asnjë strukturë të PDK-së dhe i njëjti është UD i drejtorit, sepse kjo drejtori do t'i takoj ashtu siç ka qenë shoqërisë civile.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-kërkoj që të mos keqinformohet opinioni publik, lidhur me gjendjen financiare të kompanisë “Përparimi”, për faktin se ajo është në gjendje stabile dhe ndodhet në fazën e realizimit të disa investimeve kapitale. Prandaj nuk do të ketë kurrfarë problemi me realizimin e pagave për punëtorët e saj.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e tij lidhur me rendin e ditës, shtoi se kryetari i komunës edhe disa praktika që kanë qenë pozitive në kuvend ka fillua t'i anashkaloj, kjo për faktin se pika lidhur me dekorata për nder të 17 qershorit ditës së çlirimit, e ka proceduar pa përfillur KPF-në dhe në kundërshtim me statutin dhe rregulloren e kuvendit dhe rregulloren për ndarjen e dekoratave. Ai vlerësoi se askujt nuk i bën nder të ndahen titujt më të lartë në komunë, duke shkelur procedurat ligjore duke mos i kaluar nëpër KPF, sepse zakonisht për këto pika ka pasur njëfarë uniteti politik për të nderuar figurat e dalluara të qytetit tonë. Lidhur me çështjen e shujtave për punëtorët e administratës së komunës tha se nuk është në rregull që ky vendim të qëndroj për tre apo katër muaj në sirtar, pa marr një epilog kjo çështje as nga MAPL e as nga kryesuesja e kuvendit, pavarësisht të gjitha këtyre këtë çështje ata do ta përkrahin.

Në vazhdim, kuvendi me 25 vota “për” sa ishin edhe prezent në sallën e mbledhjes, vendosi që të inkorporohet në rendin e ditës për shqyrtim Propozim – vendimi për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 prill 2024.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, për rregullimin e kanalizimit në Rr. “Enver Musa” në Vushtri.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave për nder të 17 qershorit, ditës së çlirimit.
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Ndërmarrjes Regjionale të Mbeturinave KRM “Uniteti”, për vitin 2024.
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, dega në Vushtri.
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.
8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren Buxhetore Nr.01/2025.
9. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 prill 2024.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datën 25 prill 2024.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, për rregullimin e kanalizimit në Rr. “Enver Musa” në Vushtri;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për”, vendosi me sa vijon:

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bekim, Kadri, Ferki dhe Isak Krasniqi, në pjesë ideale prej $\frac{1}{4}$.

2. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-01121-1, në sipërfaqe prej 65 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7074m² ZK Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me pjesën e parcelës kadastrale P-70202016-00939-2, në sipërfaqe prej 65m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 238 m² ZK Vushtri, pronë e Bekim, Kadri, Ferki dhe Isak Krasniqi, me pjesë ideale $\frac{1}{4}$.

3. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë, bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

4. Këto prona i janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e pronave të paluajtshme pranë Departamentit të tatimit në pronë, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave për nder të 17 qershorit, ditës së çlirimit.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-sqaroi se, konform rregullores për dekorata e ka themeluar komisioni komunal për hartimin e propozimit për ndarjen e dekoratave, prandaj bazuar në neni 18 të kësaj rregulloreje ku thuhet: Propozimet për dekorata duhet të paraqiten te Komisioni për Shqyrtimin e Propozimeve të tyre me shkrim, së paku 15 ditë para datës në të cilën merret vendimi për ndarje të dekoratës, dhe kështu këto propozime i dërgohen drejtpërdrejtë kuvendit e jo Komitetit për Politikë dhe Financa, nëse ndryshe do të ishte atëherë duhet të ridraftohet kjo rregullore për dekoratat.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se, është evident fakti se të gjitha propozimet dhe dokumentet e rëndësishme duhet të kalojnë nëpër filtrin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe kjo nuk ka ndodhur sa i përket propozimit për dekoratat dhe tani nuk mund të ndalemi në këtë pikë sepse nuk ka kohë për një vonesë të tillë tutje. Pastaj shtoi se, këtij propozimi i mungon lista e mirënjohjeve, andaj do të ishte mirë që këto propozime të bëhen këtu në mbledhje të kuvendit.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se, i vjen mire që propozimi i saj i bërë para disa seancave, që z. Bujar Muli është hy në propozim për çmimin krenaria e sportit, ndërsa propozoi që të futet në propozim për këtë çmim edhe z. Rron Kasumi.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se, është gabim që ne akoma si institucion nuk e kemi një listë me emrat e të burgosurve politikë që nga viti 1981 e tutje, në etapa të ndryshme. Ai propozoi që çmimi nderi i qytetit t'i ndahet z. Ilmi Muzaqit, ish i burgosur politik, që është veprimtar i çështjes kombëtare. Po ashtu, ai propozoi që të dekorohet edhe z. Arsim Gërxhaliu, i cili ka dhënë kontribut të çmuar në fushën e mjekësisë ligjore, me ekspertizën e tij.

Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së, pasi i përshëndeti të pranishmit, në adresimin e tij në cilësinë e kryesuesit të komisionit për hartimin e propozimit për dekorata, deklaroi: duke ju referuar rregullores për dekorata sqaroi se iniciativa për të bërë propozimet për dekorata i takon kryetarit të komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, 1/3 e anëtarëve të kuvendit dhe nismës qytetare në sajë të 700 nënshkrimeve. Duke ju referuar po ashtu dispozitave të rregullores citoj se:

Propozimet për dekorata duhet të paraqiten te Komisioni për Shqyrtimin e Propozimeve të tyre me shkrim, së paku 15 ditë para datës në të cilën merret vendimi për ndarje të dekoratës, ndërsa neni vijues përcakton, citoj: Përfundimisht nga paragrafi 7 i këtij neni, në rrethana të arsyeshme që vlerësohet nga komisioni për dekorata se nuk ka qenë e mundur të paraqitet propozimi për dekorata. Ky afat mund të jetë edhe më i shkurtër, por jo më pak se 72 orë nga dita kur merret vendimi lidhur me to. Prandaj, bazuar në dispozitat e cituara, këto organe kanë pasur mundësinë ligjore që bëjnë propozimet e tyre në afat ligjor, duke ia adresuar komisionit e më pas kuvendi do të vendoste për to, me anë të votimit. Meqë këta mekanizma ligjor nuk janë shfrytëzuar, atëherë është lëshuar afati ligjor dhe kësaj propozimet sot në mbledhje të kuvendit nuk mund ti nënshtrohen votimit.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se, kjo pikë e rendit të ditës fare nuk është proceduar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe kështu komitetit i është pamundësuar që bëjë propozimet për këto çmimet kryesore. Tutje shtoi se, bazuar në 1/3 e anëtarëve të kuvendit duhet të merret për bazë dhe të futet në votim propozimi që z. Arsim Gërxhaliu ti ndahet çmimi “Emblem e Vushtrisë”. Ndërsa propozimi që është ardhur në kuvend për z. Emin Musa, nuk i plotëson kushtet pasi që ai nuk është qytetar i Komunës së Vushtrisë, ndërsa ky çmim ndahet vetëm për qytetarët e Komunës sonë.

Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së-sqaroi se, tani janë shterur të gjitha mundësitë ligjore, për të bërë propozime, sepse janë kaluar afatet ligjore dhe kështu po del se Komitetit për Politikë dhe Financa nuk e ka kryer detyrën e tij që të bëjë propozimet me kohë, andaj komisioni nuk ka mundur të merret me propozime imagjinatave dhe inekzistente.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se, nuk është mirë të tentohet të hedhet përgjegjësia diku tjetër pa pasur asnjë fakt. Ajo që është e vërtetë është fakti se kjo pikë fare nuk ka ardhur në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe komiteti nuk ka mundur të bëjë propozim sepse nuk ka pasur fare material. Kjo i bie se komitetit i është pamundësuar t’i bëjë propozimet. Në rastin konkret komisioni për dekorata nuk i ka kryer obligimet që ka pasur që këtë material përmes DKRS-së ta procedoj në Komitetin për Politikë dhe Financa, prandaj komisioni ka dështuar në kryerjen e detyrave që i ka pasur për obligim t’i kryej. Për më tepër komisioni ka sjellë propozime në kundërshtim me rregulloren, sepse çmimi “Nderi i Qytetit” i ndahet qytetarëve të Komunës së Vushtrisë, ndërsa peroni i propozuar është i Komunës së Mitrovicës. Për të mos ardhur në pozicion të palakueshëm mendojmë nëse keni vullnet të shtohet edhe një propozim për çmimin “Emblema e Vushtrri” dhe kësaj të tejkalohej kjo situatë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se, të gjitha propozimet që dërgohen në kuvend fillimisht ato duhet të shqyrtohen nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa, meqë një gjë e tillë nuk ka ndodhur, atëherë komitetit i është marr mundësia ligjore që t’i bëjë propozimet e tij të cilat i kanë takuar në saje të rregullores.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se, vitin e kaluar për pos dhjetë mirënjohjeve që i ka ndarë kuvendi i komunës edhe pesë sosh i ka ndarë kryetari i komunës, por i rikujtoj kryetarit të komunës që njëri nga këta është harruar që ti ndahet mirënjohja nga ana e kryetarit të komunës bëhet fjalë për z. Rasim Vatovci, kërkoj që të përmirësohet ky lëshim dhe në bashkëpunim me Drejtorin e Bujqësisë t’i ndahet mirënjohja këtij fermeri, duke e zbatuar vendimin. Në emër të LVV-së propozoi për mirënjohje post-mortum z. Hilmi Haradinaj, i cili ka dhënë një kontribut të çmuar në fushën e arsimit si mësimdhënës dhe drejtor shkolle, por një kohë ka jetuar dhe vepruar në mërgatë ku ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në arsimin e nxënësve shqiptar në ekzilë.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se, i përkrah sqarimet që i bëri kryesuesi i komisionit për ndarjen e dekoratave dhe gjykoj se ka qenë afati ligjor kur është dashur të bëhen propozimet e dhe

nga KPF-ja, por një gjë e tillë nuk është shfrytëzuar dhe tani jemi në situatën kur ato duhet të votohen.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se, këtu po tentohet se kush i pari po propozon dhe askush nuk e ka mendje për ta nderuar dikë, por më shumë po luftohet për përfituar secili për veten e tij. Kjo ka bërë të zhytëmi një nivel të ulët ku është degraduar debati, dekorata dhe vetë kuvendi i komunës.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se, përgjegjësinë kryesore për moskryerjen e obligimeve dhe detyrave është komisioni për dekorata dhe është e padrejtë nga ana e kryesuesit të këtij komisioni që tenton të fajësojë Komitetin për Politikë dhe Financa. Ai apelon që këto propozime të votohen dhe kështu të përmbillet kjo pikë e rendit të ditës.

Albanez Tahiraj, drejtor i DKA-së, duke sqaruar lidhur me rrjedhën e propozimeve dhe punën e komisionit, vlerësoi se dita e çlirimit 17 qershor është dhe festohet për çdo vit, rregullorja për dekorata nuk mjafton vetëm të aprovohet, por e njëjta edhe duhet të lexohet dhe të zbatohet nga të gjithë. Pastaj konsideron se nëse propozimet për çmimet kryesore do të viheshin para Komitetit për Politikë dhe Financa, atëherë do të thyhej parimi i konfidencialiteti në raport me qytetarët. Në një logjikë të tillë atëherë do të duhej të thirren qytetarët nga ana e komisionit për të bërë propozimet për këto dekorata.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se, ky debat është duke u stërzgjatur dhe ceku se është e vërtet se ka gabime për sa i përket procedimit të këtij materiali, për faktin se anëtarët e kuvendit është dashur të njoftohen së paku një muaj për këto pika të rendit të ditës. Pastaj, lidhur me çmimin “Emblema e Vushtrrisë” ceku se ai e ka bërë këtë propozim duke menduar se z. Emin Musa është qytetar i Komunës së Vushtrrisë. Në këtë kontekst vlerësoi se nuk është qëllim që dikush të përfitoj, por të votohet unanimisht ashtu që këto figura të nderohen dhe jo të shtyhem me vota. Ai konsideron se z. Ilmi Muzaqi është figurë e njohur që ka dhënë për çështjen kombëtare dhe të njëjtit pajtohet se duhet t’i ndahet ky çmim, “Emblema e Vushtrrisë”. Më tej, për të qenë krejtësisht transparent, njoftoi se arsye se përse nuk ka sjellë listë të mirënjohjeve është fakti se vitin e kaluar është mbetur pa mirënjohje babi i një dëshmori dhe ai ishte thyer shpirtërisht, dhe më qëllim që mos të vijmë deri te kjo situatë, fare nuk ka sjellë një listë të tillë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me titullin **“Qytetar nderi”** i Komunës së Vushtrrisë nderohet **Çifti Buçinca znj. Naxhije dhe (z.Fahri Buçinca post-mortum)**, për kontributin e tyre të dhënë për Komunën e Vushtrrisë në fushën e arsimit dhe kulturës.

2. Dorëzimi i këtij titull do të bëhet nga Kryetari i komunës më datë 17 qershor - “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Me këtë vendim, në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me titull “**Nderi i qytetit**” i Komunës së Vushtrrisë, nderohet **znj. Dinore Curri**, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, organizatore e demonstratave të vitit 1982 në Vushtri, e burgosur për veprimtari politike dhe pjesëtare e luftës së fundit të UÇK-së.

2. Dorëzimi i këtyre dekoratave (titujve) do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 17 qershor “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Me këtë vendim në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me çmimin “**Emblema e Vushtrrisë**”, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare nderohen;

1.1. z. Emin Musa, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare si ish-epror i lartë i UÇK-së, TMK-së dhe FSK-së;

1.2. z. Ilmi Muzaqi, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, organizator i demonstratave të viti 1981, ish i burgosur politik.

2. Dekoratat nga pika një (1) e këtij vendimi do t’i dorëzoi Kryetari i komunës në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2024.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Me këtë vendim në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me çmimin “**Krenaria e Sportit të Vushtrrisë**” nderohet **z. Bujar Muli**, për të arriturat e tij në sportin e peshë-mbajtjes si rekordmen në peshëmbajte të rënd prej 1531 kg mbi trup, i cili ka hyrë në librin e guinness si njeriu më i fortë në botë.

2. Dorëzimi i këtij çmimi bëhet në mënyrë solemne nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2024.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e mirënjohjeve për nder të 17 qershorit ditës së çlirimit, kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, 2 vota “abstenim”, vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, Kuvendi i komunës për nder të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, më 17 qershor ndanë këto mirënjohje:

- 1.1.** Man Hoti - (post mortum), për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, pjesëmarrës dhe organizator i demonstratave të vitit 1981, ish i burgosur politik;
- 1.2.** Lavdim Shaqiri – (post mortum), i vrarë nga forcat pushtuese serbe- Martir i Kosovës;
- 1.3.** Hilmi Haradinaj – (post mortum), për kontributin e dhënë në fushën e arsimit, mësimdhënës dhe ish-drejtor shkolle;
- 1.4.** Ferki Përçuku – për kontributin e dhënë në fushën e arsimit, veteran i arsimit dhe ish-drejtor shkolle;
- 1.5.** Hamdi Kasumi, veteran i arsimit, i cili dha një kontribut të çmuar në fushën e arsimit, ish-drejtor shkolle;
- 1.6.** Brahim Maxhuni, për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë, gjegjësisht në lëmin e Otorinolaringologjisë;
- 1.7.** Ferdane Pllana – Zabërgja, për kontributin e dhënë në fushën e letërsisë;
- 1.8.** Shkelzen Syla – (post mortum), për kontributin e dhënë në luftën fundit dhe kontribut të çmuar në Policinë e Kosovës;
- 1.9.** Gëzim Behrami, për kontributin e dhënë në fushën e sportit, Kampion në Kik-boks;
- 1.10.** Zeqir Morina, për kontributin e dhënë për çlirimin e Kosovës, ish-pjesëtar i UÇK-së.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtoritë e tjera kompetente komunale.

3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. *Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Ndërmarrjes Regjionale të Mbeturinave KRM “Uniteti” për vitin 2024.*

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-pasi i përhëndeti gjithë të pranishmit tha se, para veti kemi një informatë apo raport, i cili as për së afërmi nuk i plotëson kriteret bazë që i parasheh Ligji për Ndërmarrjet Publike, dhe mund të thuhet se është një raport apo informatë skandaloze, sepse janë paraqit tri apo katër elemente shumë të parëndësishme, ku është përshkruar sa biznese janë pasive sa janë aktive, sa kamion me mbeturina janë bartë, ndërsa sa i përket aspektit financiar as edhe një element i vetëm. Andaj duke ju referuar Ligjit për Ndërmarrjet Publike neni 30, citoj: *Deri me 31*

tetor të çdo viti kalendarik, zyrtarët e secilës NP duhet të përgatisin Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik. Ky plan duhet që së pari ti dorëzohet për miratim Bordit të Drejtorëve. Pas miratimit, Plani Afarist i dorëzohet, për qëllime të informimit vetëm, sipas rastit, Ministrit dhe Qeverisë ose Komisionit(eve) përkatëse Komonale të Aksionarëve. Plani Afarist duhet të analizojë së paku, si vijon: një përshkrim të synimeve afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen nga NP si dhe orarin për realizimin e tyre; b) mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre synimeve; c) përcaktimin e shpenzimeve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrës për financimin e shpenzimeve; d) veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve; dhe detyrimet e NP karshi konsumatorëve dhe publikut.

Prandaj pyetja e tij ishte sa ka qenë vlera financiare e planit të biznesit për vitin kalendarik 2023, cili ka qenë përshkrimi i synimeve afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen në ndërmarrjen publike si dhe orarin për realizimin e tyre, mënyrat e zgjedhur për arritjen e këtyre synimeve, përcaktimi i shpenzimeve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrën e financimit të shpenzimeve, veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve dhe mbulimi i detyrimeve të ndërmarrjes publike karshi konsumatorit dhe publikut, brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tre mujori kalendarik, zyrtarët e ndërmarrjes publike përgatisin dhe dorëzojnë në bordin e drejtorëve një raport të sapo përfunduar, ndërsa bordi i drejtorëve brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit tremujor secilin raport të tillë ja paraqet Komisionit të Aksionarëve. Prandaj pyeti se ku janë raportet e tremujorit të parë, dytë dhe tretë apo raportit nëntë mujor. Çdo ndërmarrje publike e ka për obligim ligjor t'i nënshtrohet një auditimi të jashtëm vjetor dhe objektiv, nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar, dhe pyeti ku është dokumenti bazë i auditimit të jashtëm që nuk është paraqitur në këtë dokument. Raporti për përmbushjen e nevojave tjera të ndërmarrjes publike me përgjegjësi të kryeshefit ekzekutiv rregullisht duhet të testoj kënaqësinë e konsumatorëve për shërbimet që i ofron ndërmarrja, pyetja është se ku është ky raport që tregon kënaqësinë e konsumatorëve. Vlerësimi i efektivitetit të bordit, sepse bordi i drejtorëve në baza vjetore bënë vlerësimin sistematik të performancës së vetë dhe është i obliguar të hartoj raportin dhe më pas ky raport i dorëzohet komisionit të aksionarëve por që një raport nuk ekziston fare. Të gjitha ndërmarrjet përgatisin dhe vejnë në fuqi rregulloret të cilat bëhen konform Ligjit për Shoqëritë Tregtare, ku miratimi, ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i tyre është kompetencë ekskluzive e Komisionit Komunal të Aksionarëve, pyetja për komisionin është se cilat rregullore i keni miratuar, ndryshuar, plotësuar apo shfuqizuar. Mbledhje e Komisionit të Aksionarëve për vitin paraprak sa mbledhje ka mbajtur komisioni, në ato mbledhje çfarë është rekomanduar bordit, ku janë procesverbalet e atyre mbledhjeve, nëse keni bërë rekomandime a janë përfillur ato rekomandime nga ana e bordit, për faktin se komisioni në ligjërisht në mënyrë rigoroze e mbikëqyr bordin e drejtorëve, sikurse që bordi e mbikëqyr kryeshefin ekzekutiv. Në fund lidhur me bilancin përfundimtar, të hyrat dhe shpenzimet, a ka operuar me sukses dhe bilanc pozitiv apo negativ ndërmarrja, nëse ka operuar me afarizëm financiar pozitiv sa është vlera e dividendës të ardhurat nga kapitale aksionar-financiar, nëse anëtari i komisionit të aksionarëve është në gjendje të përgjigjet, nëse jo ai propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet në mbledhjen tjetër të paraqitën të gjitha këto vërejtje në raport, nëse sot votohet kërkoj nga sekretaria e kuvendit që vota e tij të konstatohet se është votë kundër këtij raporti.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-duke ju referuar raportit të KRM. “Uniteti” vlerësoi se, është mirë që prezent është edhe kryeshefi ekzekutiv i kësaj ndërmarrje, për të raportuar mbi gjendjen financiare të kësaj ndërmarrje, për më tepër për proceset që kanë ndodhur në këtë kompani, siç e dimë Komuna e Vushtrrisë si njëra ndër aksionarët në këtë ndërmarrje me vendim individual i ka kaluar shumicën e shërbimeve i ka kaluar në N.P.L “Përparimi” dhe ne si kuvendar

por edhe qytetarë e Komunës së Vushtrrisë nuk e kemi një pasqyrë të qartë lidhur me kalimin e këtyre kompetencave në kuadër të N.P.L “Përparimi” dhe nuk e dimë as situatën e borxheve financiare sepse deri sa këto shërbime i ka kryer kompania “Uniteti” mjetet i janë paguar kësaj kompanie dhe ne duhet të dimë se cili është bilanci i borxheve, a ka pasur prerje të këtyre borxheve dhe barazim të saldoeve të pasives dhe aktives në rastin e ndërrimit të pronësisë së shërbimeve nga Kompania “Uniteti” tek ajo “Përparimi”. Duhet të kemi një pasqyrë të përgjithshme lidhur me gjendjen e aseteve që janë pjesë e aksioneve të kësaj kompanie e në të cilat bënë pjesë edhe Komuna e Vushtrrisë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se, ky raport-dokument është shumë i mangët dhe kërkoj nga komisionit i aksionarëve i kësaj ndërmarrje që të sjellë një raport konform kushteve që i kërkon ligji. Pastaj shtoi se, duhet të dihet se çfarë ka ndodhur me makinerinë punese të kësaj ndërmarrje, që i ka fituar komuna si donacione nga performanca e të cilat i ka bartur në shfrytëzim të Kompanisë “Uniteti”, sepse ne aktualisht jemi duke paguar mjete për Përparimin, për blerjen e makinerisë, në ndërkohë që këto mjete do të mund të shfrytëzoheshin nga ana e kompanisë “Përparimi”.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se, ky raport-dokument është shumë i mangët dhe shtoi se do të ishte mirë që kuvendi të kishte informacione bazike të përgjithshme lidhur me gjendje e kësaj kompanie duke përfshirë edhe strukturën udhëheqëse të saj. Pastaj, përsëriti kërkesën e tij për nevojën urgjente për eliminimin e një deponie të mbeturinave në fshatin Stanoc i Epërm, sepse e njëjta po shkakton pengesa për fermerët për t’i punuar tokat e tyre. Kërkoj që urgjentisht të merren masat adekuate nga organet kompetente, për eliminimin e kësaj deponie.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-kërkoj nga strukturat menaxhuese të japin një raport detal lidhur me gjendjen aktuale ekonomiko-financiare të kësaj ndërmarrje por edhe për sa i përket rritjes së pagave për punëtorët e saj.

Gazmend Morina, kryeshef ekzekutiv i KRM “Unitetit”-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me gjendjen e kompanisë “Uniteti” duke cekur se Komuna e Vushtrrisë ka disa obligime financiare ndaj kësaj kompanie të cilat duhet ti përmbush, në të kundërtën kompania është e shtyrë të shfrytëzoj mjetet tjera ligjore, përmes gjykatës për realizmin e këtyre borxheve.

Konkluzioni i debati: obligohet Komisioni i Aksionarëve dhe menaxhmenti i Kompanisë “Uniteti” që ta plotësoj raportin sipas vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së – dega në Vushtri.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së – dega në Vushtri, për ndarjen e mjeteve për ngritjen e një lapidari për dëshmorin Mehdi Haziri, ku ceku se shuma që do të dedikohet për këtë qëllim mund të jetë deri në 2000 €.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se, si grup kuvendar do ta përkrahin këtë kërkesë, për financimin e këtij projekti dhe përherë do të jenë në mbështetje të familjeve dhe dëshmorëve të kombit sepse vetëm ata e kanë kryer misionin ndaj atdheut. Ai dha idenë që për lapidarët që do të ndërtohen në të ardhmen këto projekte të futen në buxhetin e komunës kur ai aprovohet dhe kështu të lehtësohen procedurat për realizmin e këtyre projekteve, duke ndërtuar nga një apo dy lapidare për çdo vit buxhetor. Kjo do ishte më mirë dhe kuvendi nuk do të sfidohej në këtë formë dhe kjo do të ishte një nderim i mirëfilltë për dëshmorët e kombit.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- tha se, si grup kuvendar do ta përkrahin këtë kërkesë dhe kërkoj që shuma e këtyre mjeteve varësisht nga mundësia të ngritet, pasi që vlera e këtij projekti është rreth 6000 €.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se, kjo kërkesë është e arsyeshme pasi që familja e veç e ka përfunduar këtë lapidar për heroin e UÇK-së, prandaj do të ishte mirë që të ndihmohet kjo familje duke e rritur vlerën e kësaj kërkesë, duke e realizuar plotësisht këtë kërkesë në vlerë prej 6000€.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi, pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z. Behar Haziri, i ofrohet mbështetje financiare në shumë prej dymijë euro (2000.00 €) për financimin e ndërtimit të lapidarit për Dëshmorin e UÇK-së Mehdi (Sylë) Haziri, Zona Operative e Shalës, Brigada 142.

2. Mjetet financiare të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria: subvencione dhe transfere, **Programi Buxhetor (16024)-zyra e kryetarit.**

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-kërkoj sqarim se në cilin ligj përcaktohet se duhet të vendosen emrat e subjekteve politike në propozim-vendim. Po ashtu ky propozim-vendim ka edhe një gabim në thirrjen juridike.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se, e konteston çelësin e themelimit të këtij komisioni dhe shtoj se atyre si grup i madh kuvendar iu takon të kenë një anëtar në këtë komision. Gjithashtu ai vlerësoi se edhe profilet e propozuar për këtë komision nuk janë adekuate sepse vinë nga fusha që i takon shqyrtimit të ankesave për pronën. Për anëtar të këtij komisioni propozoi z.Ymer Haradinaj.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se, caktimi i subjekteve politike është sigurisht ndonjë gabim teknik, por ky propozim-vendim është i hartuar konform legjislacionit në fuqi.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-vlerësoi se, me që komisioni për dhënien e pronës në shfrytëzim është theluar nga anëtarët e PDK-së dhe LDK-së, komisioni për shqyrtimin e ankesave për dhënie e pronës në shfrytëzim duhet të themelohet nga anëtarët e subjekteve tjera politike, sepse kjo është më e shëndetshme për demokracinë.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-propozoi Kushtim Hyseni-n për anëtar të këtij komisioni, nga radhët e PDK-së.

Edona Gashi, anëtare e kuvendit-propozoi Adnan Lahu-n për anëtar të këtij komisioni, nga radhët e LDK-së.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit propozimet për anëtarë të këtij komisionit nga radhët e subjekteve politike i hodhi në votim në mënyrë individuale për secilin propozim dhe atë me sa vijon:

Kushtim Hyseni mori 15 vota “për”

Adnan Lahu mori 6 vota “për”

Ymer Haradinaj mori 7 vota “për”

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi, pas votimit me 21 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për shqyrtim të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në këtë përbërje:

1.1 Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit;

1.2 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit;

1.3 Maliq Ferizi, anëtar i ekzekutivit;

1.4 Hyra Uka-Hoxha, anëtare e ekzekutivit;

1.5 Blerim Ibrahimimi, anëtar i shoqërisë civile.

2. Mandati i komisionit është dyvjeçarë, brenda mandatit të tanishëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

3. Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin kryesuesin e komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

4. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores së QRK, Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e komisionit të cekur në pikën 1 (një) të këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lidhur me Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës, vlerësoi se, për këtë çështje duhet të jemi transparent dhe për më tepër kryetari i komunës duhet të jetë i sqertë, me propozimet që i jep për shujtat ditore për zyrtarë të administratës së komunës. Kur është votuar ky propozim në herën e

parë i kishte dhënë vërejtjet e tij dhe ato vërejtje kanë dalë të jenë të sakta, pas disa muajsh kur nuk ishte ekzekutuar dhe nxjerr ky vendim, tani është sjellë sërish ky propozim-vendim, por pikërisht në këto momente kryetari i komunës largohet nga mbledhja dhe kjo tregon josingëritet nga ana e tij. Ai kërkoi që para se të votohet ky propozim të sqarohet si për opinionin publik ashtu edhe për zyrtarët që do të jenë përfitues i kësaj shujte, se nga cila kategori ekonomike ku do të merren mjetet, a po ashtu cilët janë ata zyrtarë që do të përfitojnë nga ky vendim, a do të përfitojnë të gjithë të punësuarit si nga fusha e arsimit, nga shëndetësia, në kulturë në administratë e komunës në Qendrën e Mjekësisë Familjare, zyrtarët e Qendrës për Punës Sociale, në Ndërmarrjen Lokale Përparimi e kështu më radhë, pra duhet të specifikohet dhe të dihet saktë se cilat kategori do të përfitojnë nga ky vendim i kuvendit. Kjo për faktin se me një vendim të tillë të pa sqaruar mirë, ne jemi ka rrezikojmë komunën dhe stabilitetin financiar të saj, sepse këta zyrtar me anë të padive gjyqësore nga cilido sektor i komunës të kërkoj kompensimin e këtyre mjeteve. Andaj kjo është një çështje shumë serioze dhe ky nuk është një vendim vetëm ad-hoc sa për tu aprovuar, pa e ditur saktë se cilat kategori të të punësuarve do të futen në kuadër të këtij vendimi për ti gëzuar këto benefite. Si grup kuvendar i LVV-së propozojnë që mos të ketë dallime, mos të ketë ndasi në mes të punësuarve që të ju paguhet ky kompensim. Por ne jemi dëshmitar se ndasitë për këtë çështje kanë filluar akoma para se ky vendim të aprovohet, sepse kryetari i komunës i ka thirrur punëtorët e Ndërmarrjes “Përparimi” në një drekë dhe iu ka premtuar se do të iu kompensoj shujtat atyre. Kjo qasje është e pa sinqertë dhe krijon ndarje dhe përçarje. Edhe njëherë përsërit se duhet të përcaktohet dhe të dihet saktë se kujt do të iu jepet kjo shujtë cilëve zyrtarë. Prandaj është mirë që Drejtoria e Administratës si hartues i këtij propozim-vendimi të jap sqarimet e duhura se çfarë është menduar me këto kategori, sepse nëse e lëshojmë këtë çështje si të pasqaruar, punëtorë që llogariten si punëtorë të Komunës së Vushtrrisë, të çdo sektori, do ta krijojnë një alibi juridike se si kanë vepruar mësimdhënësit me anë të kontratës kolektive, që do ta padisin komunën pas disa viteve duke kërkuar kompensimin për çdo muaj dhe pasojat do t’i bartë komuna në vitet vijuese. Andaj krejt në fund vlerësoj dhe apeloj që mos të votojmë këtë vendim pa e sqaruar saktë cilat kategori janë përfitues, si grup kuvendar i LVV-së, e mbështesin këtë pikë që shujta të ndahet në mënyrë lineare dhe pa asnjë dallim.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- sqaroi se, ajo se çfarë do të ishte në rregull është se planifikimi i këtyre shujtave do të duhej që ato të futen në buxhetin e komunës në kohën e aprovimit të buxhetit vjetor të komunës dhe atë nga kategoria ekonomike paga dhe mëditje. Por ajo që paraqet problem, se nga niveli qendror i pushtetit nuk po lejohet hapja e një kodi buxhetor ku do të mund të planifikoheshin këto shujta. Tutje sqaroi se, përfitues të këtyre shujtave janë vetëm shërbyesit civil të administratës së komunës, por jo ata nga fusha e arsimit dhe ajo e shëndetësisë, sepse ata kanë tjetër status ligjor dhe të njëjtit kanë përfituar nga aktet tjera siç është kontrata kolektive. Ai propozoi që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e ardhshme ashtu që kjo çështje të sqarohet krejtësisht, sepse është e ndjeshme dhe nëse mendohet të futen edhe kategoria e arsimit dhe ajo e shëndetësisë, atëherë ky vendim do të ketë kosto të papërbalueshme financiare.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se, janë tri komponente që bëjnë këtë çështje shumë të diskutueshme dhe këtë vendim të paqëndrueshëm dhe ato janë e para se a lejon hapësirë Ligji i Pagave për pagesën e shujtave, mandej a lejohet zbatimi i këtij vendim nga kategoria subvencione dhe transfere dhe e treta nuk po dihet se kush është përfitues i këtyre shujtave cilat kategori. Pastaj nëse kjo çështje do të trajtohet me seriozitet do të mund të vendosej kjo shujtë në saje të koeficienteve të pagave, dhe kjo do të krijojë një drejtëshmëri në aspektin e ndarjes së këtyre shujtave dhe do ta lehtësonte barrën financiare për komunën. Tutje ai vlerësoi se më këtë çështje

është manipuluar dhe po tentohet të mashtrohen punëtorët e komunës, dhe me këtë kategori është duke u luajtur me ndjenjat e tyre, duke i thyer ata shpirtërisht.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit- tha se, kjo çështje është e qartë dhe pastër si kristal, se bëhet fjalë vetëm për punëtorët e komunës, shërbyesit civil në administratën e komunës që do të përfitojnë nga ky vendim, shujtat ditore.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- tha se, këtij propozim-vendimi është dashur ti bashkëngjitet edhe shkresa e MAPL-së, lidhur vlerësimet që ata i kanë dhënë, nëse veç jemi te kjo, atëherë ky propozim është dashur të filtrohet edhe nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa. Tutje nga sqarimet e bëra nga Drejtori i Drejtorisë së Financave, shihet se ky vendim do ti përfshijë vetëm punëtorët e administratës së komunës. Si grup kuvendar i LDK-së do ta përkrahin këtë pikë, por problemi kryesor do të jetë zbatimi në praktikë i këtij vendimi.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha se, nga ky vendim do të përfitojnë vetëm shërbyesit civil të administratës së komunës, sepse ata nga fusha e arsimit janë anëtarë të SBASHKUT dhe përfitojnë nga kontrata kolektive, ku edhe i kanë marrë beneficionet e tyre në rrugë gjyqësore.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-tha se, kjo çështje është mirë sqarohet para se të aprovet ky vendim, se cilat kategori do të jenë përfituese të këtyre shujtave.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-në rekapitullimin e debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, konstatoj se nga ky vendim do të përfitojnë vetëm shërbyesit civil të administratës së komunës.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 28 vota “për”, sa edhe ishin prezent në sallën e mbledhjes, vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, lejohet pagesa e shujtave në vlerë prej 3.00 € (tri euro) në ditë pune, për zyrtarë të punësuar në Administratën e Komunës së Vushtrrisë.

2. Mjetet financiare nga pika paraprake e këtij vendimi do të sigurohen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programet si në vijim: zyra e kryetarit- kodi buxhetor 16024, Shërbime Publike- kodi buxhetor 18184, Bujqësia- kodi buxhetor 47024, Kultura- kodi buxhetor 85024, Arsimi dhe shkenca- kodi buxhetor 92120, Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale- kodi buxhetor 73033, në shumë prej 240,000.00€ (dyqind e katërdhjetë mijë euro).

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari Komunës, Drejtorja për Buxhet e Financa, Drejtorja e Administratës dhe Zyra e Personelit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, dhe do të zbatohet nga data 03.01.2024.

8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren Buxhetore Nr.01/2025.

9. Pyetje dhe përgjigje:

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pyeti kryetarin e komunës se kur do të bëhet pagesa e subvencionit për fermerët e komunës sonë në vlerë prej 05 cent për litër të qumështit, për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023? Pyetja tjetër ishte deri ku ka shkuar procesi për ofrimin e

ndihmës financiare për bizneset që shtrihen në sheshin “Adem Jashari”, ku po ndërtohet parkingu nëntokësor e në ç’ rast nga punimet janë dëmtuar këto biznese në ushtrimin e veprimtarisë së tyre? Pastaj pyeti kryetarin e komunës se a ka plan konkret për mbrojtjen e qytetarëve nga qentë endacakë, të cilët janë të rrezikua e sidomos nxënësit e shkollave fillore, ai përmendi një rast ku një qenë endacak për çdo ditë i sulmon nxënësit e shkollës fillore “Migjeni” në fshatin Stanoc i Epërm. Po ashtu pyeti kryetarin e komunës se deri ku ka shkuar procesi i marrëveshjes mes komunës dhe Kompanisë “Emona”, për pronën në fshatin Gracë, ku kuvendi ka marrë vendim për autorizimin e kryetarit të komunës për kthimin e asaj prone për nevojat e komunës, kthimin në pronësi komunale? Mandej paraqiti dy kërkesa, njëra që ka të bëjë me një kanalizim mes lagjeve: Haradinaj, Pronaj dhe Maloku, ku gjendet një fermë e cila nuk ka kanalizim dhe kemi kundërmim të rrezikshëm që paraqet problem për banorët e lagjeve Pronaj dhe Maloku, e po ashtu kemi edhe ankesë për këtë çështje në Drejtorinë e Inspektimeve, andaj kërkoi që me urgjencë organet komunale të merren me zgjidhjen e kësaj problematike. Dhe kërkesa e fundit është për rregullimin e ndriçimit publik i cili është prishur që disa muaj në fshatin Stanoc i Epërm, respektivisht në rrugën “Skender Bllaca”.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-ai sqaroi dhe kërkoi falje për mungesën e tij në një pjesë të mbledhjes së kuvendit, por ishte në një takim me Kryetarin e Komunës së Mamushës, por mbledhja e kuvendit ishte shtyrë pikërisht me kërkesën e tij për ditën e hënë që të jetë prezent në mbledhje. Pastaj, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarit të kuvendit, sqaroi se pagesa subvencioneve për qumështin nuk është bërë sepse akoma nuk janë transferuar mjetet nga të hyrat e bartura, por mendon se shumë shpejt ato do të ekzekutohen dhe fermerët do t’i marrin këto mjete. Lidhur me rimbursimin për bizneset në sheshin “Adem Jashari” njoftoi se pa përfunduar projekti i parkingut nëntokësor nuk mund të bëhet pagesa sepse nuk e dimë akoma se sa është e gjatë periudha për të cilën do të kompensohen, por, sigurisht se ato biznese do të kompensohen. Pastaj lidhur me problemin e qeneve endacak vlerësoi se ky është bërë problem nacional dhe mendon që të gjendet një zgjidhje e përgjithshme, në nivel vendi. Në këtë kontekst njoftoi se në bashkëpunim me veterinarët dhe një organizatë zvicerane përmes një tenderi mendon të gjen një zgjidhje. Mandej, lidhur me rregullimin e ndriçimit publik, ceku se duhet të njoftohet kompania “Përparimi” dhe ky problem zgjidhet. Sa i përket kanalizimit në fshatin Stanoc i Epërm, njoftoi se komuna ka kontratë dhe do të evitohet ai problem atje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:40

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE :	07.06.2024
REFERENCË:	10 Nr. 492/24
PËR:	KPF dhe KK. Vushtri
PËRMES:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës
NGA:	Drejtori i DKA-së, Albanez Tahiraj
TEMA:	Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2023/2024

Drejtorja Komonale e Arsimit në Vushtri bazuar në Rregulloren (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë, paraqet këtë Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2023/2024. Komisioni punoi në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës Nr.482/2024 të datës: 30.04.2024, Konkursin për ndarjen e bursave Nr.332/24 të datës: 08.04.2024.

Informata të përgjithshme:

- **Numri i bursave brenda vendit – 70 (shtatëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një student/e për studime brenda vendit;
- **Numri i bursave jashtë vendit - 17 (shtatëmbëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;
- Vlera e bursës- 1000.00 € (një mijë) për student/e për vendet e BE-së;
- Konkursi i bursave ka qenë i hapur nga data: 11.04.2024 - 25.04.2024;
- Më datë: 26.04.2024 u pranua dokumentacioni i aplikantëve;
- Më datë: 03.05.2024 u futën të gjitha të dhënat në databazë dhe bashkë me komisionin është bërë renditja sipas notës mesatare dhe drejtimeve;
- Më datë: 16.05.2024, komisioni shpalli listën jo- përfundimtare të bursave;
- Më datën: 04.06.2024 komisioni i ankesave shqyrtoi 8 ankesa, ndërsa me vendim Nr.725/24 të dt:04.06.2024 të kryetarit të Komunës z.Ferit Idrizi janë shtuar edhe 2 bursa për studentë jashtë vendit, pasi që janë aprovuar nga komisioni i ankesave;

- Ndërsa jashtë vendi kanë tepruar 6 bursa dhe janë bartur në këtë kategori duke u bazuar në notën mesatare;
- 29 studentë kanë konkurruar nga drejtimet të cilat nuk i kemi shpallur;
- Në kategorinë brenda vendit, gjithsej 17 studentë nuk kanë përfituar bursë;
- Në kategorinë jashtë vendi ka përfituar 1 kandidat;
- Ankesa të bursave kanë qenë 8 (prej tyre, njëra ka fituar bursë por se ka vërejtur);
- Përfitues të bursave sipas gjinisë: 59 janë studente dhe 28 janë studentë;

Të gjithë kandidatët fitues/e, komisioni i renditi në bazë të notës mesatare, mbështetur në rregullore. Në drejtimet që kanë tepruar bursat, komisioni vendosi që: bursat që kanë tepruar brenda vendit, të krijohet lista e atyre që i kanë plotësuar kriteret dhe në bazë të numrit që kanë tepruar t'u jepet bursa. Ndërsa, edhe bursat jashtë vendi që kanë tepruar, t'u jepen vetëm studenteve jashtë vendit .

Lista e përfituesve:

Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Matematikë, numri i bursave Baçelor: 2, Master:1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Adelina Sefedini Gjyshinca	Matematikë	Fitues
2.	Gresa Niman Jashari	Matematikë	Fitues

Ndërsa në studimet Baçelor:1bursë, nuk ka pasur aplikantë.

Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Kimi, numri i bursave Baçelor:2, Master 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Blerina Hamit Halili	Kimi	Fitues

Ndërsa në studimet Baçelor:1bursë, dhe 1 bursë Master nuk ka pasur aplikantë.

Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Fizikë, numri i bursave Baçelor 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
	Nuk ka pasur aplikantë		

Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Biologji numri i bursave Baçelor 3, Master 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Zana Besim Gërxhaliu	Biologji	Fitues
2.	Erza Faik Cakaj	Biologji	Fitues
3.	Shkëlesa Sabri Avdiu	Biologji	Fitues
4.	Lediona Shyqyri Beqiri	Biologji	Jo fitues

Ndërsa në studimet Master: 1 bursë, nuk ka pasur aplikantë.

Fakulteti i Filologjisë: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, numri i bursave Baçelor 3			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Elda Shfeki Krasniqi	Gjuhë gjermane	Fitues

Ndërsa në studimet Baçelor: 2 bursa, nuk ka pasur aplikantë.

Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore dhe kolegjet : Shkenca-Kompjuterike, numri i bursave Baçelor 9, Master 2			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Arianit Skender Mustafa	Shkenca kompjuterike	Fitues
2.	Diane Arsim Hoti	Shkenca kompjuterike	Fitues
3.	Shkurte Fazli Mustafa	Shkenca kompjuterike	Fitues
4.	Artinë Lushaku	Shkenca kompjuterike	Fitues
5.	Gëzim Hyda Dallku	Shkenca kompjuterike	Fitues
6.	Yllka Bekim Dallku	Shkenca kompjuterike	Fitues

Ndërsa në studimet Baçelor: 3 bursa, dhe 2 bursa Master nuk ka pasur aplikantë.

Fakulteti i Inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike: Inxhinieri Kompjuterike: numri i bursave Baçelor 6, Master 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Elton Bajram Pajaziti	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Fitues
2	Erza Shyqyri Ademi	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
3	Enis Bahri Shalleci	Inxhinieri kompjuterike	Fitues
4	Qëndrim Isuf Zabergja	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
5	Arta Afrim Oshlani	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
6	Leonita Lulzim Kajtazi	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
7	Erza Avni Ademi	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues

8	Erza Valdet Merovci	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
9	Lorik Fatmir Zabërgja	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
10	Erona Muharrem Maxhuni	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
11	Arjeta Arben Llapshtica	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
12	Saranda Nuha Osmani	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
13	Agenesha Idriz Jashanica	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
14	Faton Musa Shala	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
15	Medina Veton Shabani	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
16	Erdina Blerim Gashi	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
17	Elmedina Fatos Sefedini	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
18	Olti Hysen Ademi	Inxhinieri Kompjuterike dhe softuerike	Jo fitues
19	Erza Nexhmedin Peci	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
20	Gentiana Xhafer Mehana	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
21	Ernis Shefki Pllana	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues
22	Sara Bedri Hajrizi	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Jo fitues

Ndërsa në studimet Master: 1 bursë nuk ka pasur aplikantë.

Fakulteti i Ndërtimtarisë: Gjeodezi, numri i bursave Bachelor 2, Master 2			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Dardan Idriz Muzaqi	Gjeodezi	Fitues
2.	Florim Hamit Maloku	Gjeodezi	Fitues

Ndërsa në studimet Bachelor: 2 bursa nuk ka pasur aplikantë.

Fakulteti i Mjekësisë – Mjekësi e përgjithshme, numri i bursave Bachelor 15			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Ejona Bashkim Hasani	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
2.	Enis Murteza Poturqoj	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
3.	Leonela Sami Sallahu	Mjekësi e përgjithshme	Fitues

4.	Mirlinda Hasan Maxhuni	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
5.	Adea Nuha Hasani	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
6.	Çendrim Gzim Mehmeti	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
7.	Genta Gazmend Dervishi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
8.	Yllmir Sami Merovci	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
9.	Genta Abit Abiti	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
10.	Jasmina Arben Cakaj	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
11.	Fiona Basri Zejnullahu	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
12.	Ermal Shemi Hyseni	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
13.	Vera Shukri Xhaferi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
14.	Ardian Latif Hyseni	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
15.	Bleona Enver Seferi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
16.	Egzona Albert Parduzi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
17.	Gëzim Ali Mustafa	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
18.	Enisë Bylent Maxhuni	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
19.	Dafina Ramë Ademi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
20.	Krenar Arban Krasniqi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
21.	Azemine Gëzim Islami	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
22.	Diellza Arben Pllana	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
23.	Lindrit Hashim Uka	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
24.	Vesa Nexhmi Shallici	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
25.	Erza Bekim Bajrami	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
26.	Arta Mexhit Maliqi	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues

Fakulteti i Mjekësisë – Stomatologji, numri i bursave Baçelor 3			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Auron Raif Merovci	Stomatologji	Fitues
2	Aurela Burim Salihu	Stomatologji	Fitues
3	Anita Ferki Abazi	Stomatologji	Fitues
4	Viola Sami Haxhaj	Stomatologji	Jo fitues
5	Riola Arment Kutllovci	Stomatologji	Jo fitues
6	Kushtrim Qamil Ibishi	Stomatologji	Jo fitues
7	Alisa Rafet Kelmendi	Stomatologji	Jo fitues
8	Blerina Driton Sinani	Stomatologji	Jo fitues
9	Aurora Kajtaz Hajdini	Stomatologji	Jo fitues
10	Sejdi Bahri Karaça	Stomatologji	Jo fitues

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë: Mjekësi Veterinare, numri i bursave Baçelor 2, Master 2			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
	Nuk ka pasur aplikantë		

Fakulteti i Arkitekturës: Arkitekturë, numri i bursave Baçelor 5, Master 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Riona Naim Azemi	Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor- Master	Fitues
2.	Yll Sabit Spanca	Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor	Fitues
3.	Amira Gjyshinca	Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor	Fitues
4.	Anisa Menxhiqi	Arkitekturë	Fitues
5.	Jonila Sami Haxhaj	Arkitekturë	Fitues
6	Alma Naim Hyseni	Arkitekturë	Fitues
7	Medina Bejtush Zymeri	Arkitekturë, Master	Jo Fitues
8	Arbesa Zymer Merovci	Arkitekturë. Dizajn enterier	Jo fitues
9	Besfort Izet Kadriu	Arkitekturë	Jo fitues

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Automatikë e Kompjuterizuar dhe Robotikë, numri i bursave Baçelor 2, Master 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Kreshinik Xhemshit Dibrani	A. dhe Robotikë	Fitues
2	Shkurta Skender Bunjaku	E. dhe Robotikë	Fitues

Ndërsa në studimet Master: 1 bursë nuk ka pasur aplikantë.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Elektronikë, numri i bursave Baçelor 2, Master 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Gresa Fatos Salihi	Elektrotronikë	Fitues
2	Erdona Sherif Krasniqi	Elektrotronikë	Fitues

Ndërsa në studimet Master: 1 bursë nuk ka pasur aplikantë.

Bursa për studentët jashtë vendit: Mjekësi, numri i bursave Baçelor 5			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Fjolla Xhvdet Zeqiri	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
2	Albin Avni Tahiri	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
3	Blerta Hysni Duraku	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
4	Albin Shkuri Xhaferi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
5	Anesa Ilmi Karaça	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
6	Behar Shemsi Bunjaku	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
7	Ema Adnan Behrami	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
8	Drilon Burhan Pajaziti	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues

9	Eron Ramadan Merovci	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
10	Dion Agim Bregaj	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
11	Dea Halil Zabërgja	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues
12	Erza Halil Zabërgja	Mjekësi e përgjithshme	Jo fitues

Bursa për studentët jashtë vendit: Arkitekturë, numri i bursave Baçelor 1, Master 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
	Nuk ka pasur aplikantë		

Bursa për studentët jashtë vendit: Shkenca kompjuterike, numri i bursave Baçelor 2, Master 1			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
	Nuk ka pasur aplikantë		

Bursa për studentët të vendeve të Bashkimit Evropian: numri i bursave 5 Baçelor			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1	Festina Sabri Avdiu	FEI Bs. Comp.Science T.	Fitues
2	Shpetim Isuf Jashari	Information and Comp.	Fitues
3	Floriana Nuradin Beqiri	PHYSIK-B	Fitues
4	Ridvan Ruzhdi Plluzhina	Shkenca kompjuterike	Fitues
5	Vlera Gadaf Mulaku	PA Information T.	Fitues

Studentët të cilët përfitojnë bursë brenda vendit nga bursa e mbetur që kalon në fusha tjera bazuar në notën mesatare:			
Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Medina Bejtush Zymeri	Arkitekturë	Fitues
2.	Viola Sami Haxhaj	Stomatologji	Fitues
3.	Egzona Albert Parduzi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
4.	Riola Arment Kutllovci	Stomatologji	Fitues
5.	Gëzim Ali Mustafa	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
6.	Enisë Bylent Maxhuni	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
7.	Kushtrim Qamil Ibishi	Stomatologji	Fitues
8.	Dafina Ramë Ademi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
9.	Krenar Arban Krasniqi	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
10.	Azemine Gëzim Islami	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
11.	Alisa Rafet Kelmendi	Stomatologji	Fitues
12.	Erza Avni Ademi	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
13.	Diellza Arben Pllana	Mjekësi e përgjithshme	Fitues

14.	Erza Valdet Merovci	Inxhinieri Kompjuterike dhe sofuerike	Fitues
15.	Blerina Driton Sinani	Stomatologji	Fitues
16.	Aurora Kajtaz Hajdini	Stomatologji	Fitues
17.	Lindrit Hashim Uka	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
18.	Lorik Fatmir Zabërgja	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
19.	Vesa Nexhmi Shalci	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
20.	Erona Muharrem Maxhuni	Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri	Fitues
21.	Erza Bekim Bajrami	Mjekësi e përgjithshme	Fitues

Studentët të cilët përfitojnë bursë jashtë vendi nga bursa e mbetur që kalon në fusha tjera bazuar në notën mesatare:

Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Behar Shemsi Bunjaku	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
2.	Emad Adnan Behrami	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
3.	Drilon Burhan Pajaziti	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
4.	Eron Ramadan Merovci	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
5.	Dion Agim Bregaj	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
6.	Dea Halil Zabërgja	Mjekësi e përgjithshme	Fitues
7.	Erza Halil Zabërgja	Mjekësi e përgjithshme	Fitues

Studentët të cilët nuk përfitojnë bursë pasi që kanë aplikuar në drejtimet që nuk janë të shpallura me konkurs ose studentë të vitit të parë

Nr.	Emri (prindi) mbiemri	Programi/drejtimi	Kandidat: fitues/jo fitues
1.	Elmira Ilir Selimi	FSHMN-Matematikë Financiare	Jo fitues
2.	Verona Ferit Zeqiri	FIEK- Telekomunikacion	Jo fitues
3.	Arlinda Xhavit Bunjaku	IEK- Teknologji e Iformacionit dhe Komunikim	Jo fitues
4.	Arendë Avdullah Hajdini	IMK- Inxh. Ekonomike	Jo fitues
5.	Dafina Naim Ademi	IMK- Inxh. Ekonomike	Jo fitues
6.	Elma Abdurrahim Sallahu	IMK- Inxh. Ekonomike	Jo fitues
7.	Edin Murat Mehmeti	FB-UBT Shkencat e ushqimit dhe bioteknologjisë	Jo fitues
8.	Adelina Zuka Hajra	FBV- Prodhimtari bimore	Jo fitues
9.	Laureta Dobërdoli	Arsim Fillor	Jo fitues
10.	Besman Fahri Hoti	P.Ed.fizik dhe sport	Jo fitues
11.	Drenusha Shemsedin Vërbovci	UBT Menaxhim i Mekatronikes	Jo fitues
12.	Erza Bekim Kutllovci	Banka , Financa dhe Kotabilitet	Jo fitues
13.	Fjolla Naim Ademi	Biznes dhe Menagjment	Jo fitues
14.	Bleona Fidaim Zekolli	Biznes dhe Menagjment	Jo fitues
15.	Fortesa Sabri Avdiu	F.Punë sociale	Jo fitues
16.	Suela Kurti	Matematikë financiare	Jo fitues

17.	Dafina Izahir Mehmeti	Materiale -Metalurgji	Jo fitues
18.	Erëza Erkan Gjyshinca	Inx. Ekonomike	Jo fitues
19.	Gentiana Ilmi Xhafa	UBT Infermieri	Jo fitues
20.	Fatlinda Xhavit Hyseni	Rexhi filmi dhe tv	Jo fitues
21.	Diellza Xhavit Hyseni	Arte Konceptuale dhe Media te reja	Jo fitues
22.	Aulent Arben Rashica	Makineri prodhuese	Jo fitues
23.	Adisa Isuf Hamdiu	Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve	Jo fitues
24.	Albion Musa Hajrizi	Edukatë fizike	Jo fitues
25.	Edona Ali Mustafa	Infermieri e përgjithshme	Jo fitues
26.	Rinesa Fehmi Maxhuni	In. dhe teknologji ushqimore	Jo fitues
27.	Anisa Mustafa	Teknik I radiologjisë	Jo fitues
28.	Bleron Ekrem Kovaçi	UBT-Inxh Mekatronikës	Jo fitues
29	Eda Bekim Dallku	Marrëdhënie ndërkombëtare	Jo fitues

Ankesat e studentëve:

Besfort Kadriu, student i FNA-Arkitekturë, nuk i ndahet bursa komunale për vitin akademik 2023/2024. Nuk ka qenë në listën e përfituesve pasi që në Rregulloren (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 6; Kriter për vlerësim të ndarjes së bursave merret nota mesatare, me përparësi nota më e lartë. Prandaj në konkurrencën ku ai ka konkurruar ka qenë i fundit i renditur me notë mesatare. Ndërsa edhe nga bursa e mbetur mbështetur në konkursin e bursave; Nëse nuk ka kandidatë student/e të mjaftueshëm në një fushë, atëherë bursa e mbetur kalon te fushat tjera, brenda konkursit bazuar në notën mesatare; ka qenë i radhitur në me numër 37, nga 21 që kanë përfituar.

Eda Dallku, studente e Fakultetit të shkencave politike- Marrëdhënie Ndërkombëtare, Sakary -Turqi, nuk i ndahet bursa komunale për vitin akademik 2023/2024. Nuk ka qenë në listën e përfituesve pasi që në Konkursin për ndarjen e bursave Nr.332/24 të datës: 08.04.2024 nuk e kemi shpall drejtimin që ka aplikuar, por vetëm për vendet e BE-së, janë përfshirë drejtimet të ndryshme. Por, Turqia nuk është në BE dhe kjo nuk ka hyrë fare në konkurrencë.

Gentiana Mehana, FIMK- Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri, nuk i ndahet bursa komunale për vitin akademik 2023/2024. Nuk ka qenë në listën e përfituesve pasi që në Rregulloren (KKV) Nr.01/2023, për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 6, Kriter për vlerësim të ndarjes së bursave merret nota mesatare, me përparësi nota më e lartë. Prandaj në konkurrencën që ka konkurruar ka qenë me numër 20 e renditur me notë mesatare, nga 5 studentë që kanë përfituar. Ndërsa edhe nga bursa e mbetur, mbështetur në konkursin e bursave. Nëse nuk ka kandidatë student/e të mjaftueshëm në një fushë, atëherë bursa e mbetur kalon te fushat tjera. Brenda konkursit, bazuar në notën mesatare, ka qenë e radhitur në me numër 36, nga 21 që kanë përfituar.

Sejdi Karaça, student i FM-Stomatologji, nuk i ndahet bursa komunale për vitin akademik 2023/2024. Nuk ka qenë në listën e përfituesve pasi që në Rregulloren (KKV) Nr.01/2023, për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023. Neni 6, Kriter për vlerësim të ndarjes së bursave merret nota mesatare, me përparësi nota më e lartë. Prandaj në konkurrencën në të cilën ka konkurruar ka qenë me numër 10 i renditur me notë mesatare, nga 3 studentë që kanë përfituar, pra i fundit në listë. Ndërsa edhe nga bursa e mbetur mbështetur në konkursin e bursave. Nëse nuk ka kandidatë student/e të mjaftueshëm në një fushë, atëherë bursa e mbetur kalon te fushat tjera. Brenda konkursit bazuar në notën mesatare, ka qenë i radhitur në me numër 23, nga 21 që kanë përfituar. Rregulloren (KKV) Nr.01/2023, për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023: nuk i përjashton studentët e kolegjeve private. Neni 3. pika 4.

Emra Behrami, studente e F. Mjekësi e përgjithshme- Tetovë, i ndahet bursa komunale për vitin akademik 2023/2024, pasi që edhe në listën jopërfundimtare ka qenë përfituese e bursës (shih vendimin me Nr.436/24, të datës:16.05.2024. f.7). Studentët të cilët përfitojnë bursë jashtë vendi nga bursa e mbetur që kalon në fusha tjera bazuar në notën mesatare: Nr.2.


Elmira Ilir Selimi, studente e FSHMN-Matematikë Financiare, nuk i ndahet bursa komunale për vitin akademik 2023/2024, pasi që në Konkursin për ndarjen e bursave Nr.332/24 të datës: 08.04.2024, nuk është i shpallur ky drejtim.

Erza Halil Zabërgja, studente e F. Mjekësi e përgjithshme- Tetovë, i ndahet bursa komunale për vitin akademik 2023/2024. Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, bazuar në kërkesën e komisionit të ankesave të bursave, 10Nr.473/24 datë: 31.05.2024, që të përfshihen edhe 2 studentë jashtë vendit, ka marr vendim Nr.725 /24, dt. 04.06.2024, që t'i lejohet ndarja e bursës.



Vlera Gadaf Mulaku, Studente e PA Inoforation T. – Split, Kroaci, i ndahet bursa komunale për vitin akademik 2023/2024. Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, bazuar në kërkesën e komisionit të ankesave të bursave, 10Nr.473/24, datë: 31.05.2024, që të përfshihen edhe 2 studentë jashtë vendit, ka marr vendim Nr.725 /24, dt. 04.06.2024, që t'i lejohet ndarja e bursës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUCITRN

DATE	07/06/2024
PËR/ZA/TO:	Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES:	Ferit Idrizi, Kryetar i komunës 
NGA/OD/FROM:	Hyrie Uka Hoxha  Drejtoresë e Drejtorisë për Administratë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informata e punës për periudhën Janar - Qershor

Duke u bazuar në Planin e Punës të Kuvendit për vitin 2024, i cili parasheh që ne si drejtori të paraqesim informata gjashtë mujore lidhur me punën dhe përgjegjësitë, Drejtoria për Administratë bashkëngjit informatat e shërbimeve dhe punët e drejtorisë.



Drejtoria për Administratë

**Informatë e punës
Janar-Qershor-2024**

Datë: 06.06.2024

Informata lidhur me punën e Drejtorisë për Administratë përmban aktivitetet duke u bazuar në fushat dhe përgjegjësitë që drejtorja ka sipas ligjeve, statutit të komunës dhe akteve tjera normative.

Informata përfshinë periudhën e raportimit nga janari deri qershor, duke u koncentruar në aktivitetet që kanë të bëjnë me avancimin e administratës dhe shërbimeve ndaj qytetarëve, ofrimin e shërbimeve të përbashkëta për organet e brendshme të komunës si dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga fusha e përgjegjësisë që i bie drejtorisë.

Është punuar në avancimin e administratës, duke punuar në interesin e qytetarëve dhe duke ofruar shërbime sa më të mira për qytetarët. Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria për Administratë ka arritur që avancimi i administratës vazhdon të jetë një ndër prioritetet e qeverisë komunale, ku ka ofruar shërbimet e veta qytetarëve dhe organeve tjera komunale (drejtorive, kuvendit dhe zyrave tjera) me të gjitha kapacitetet që i ka pasur në dispozicion.

Bazuar në planin e punës objektiv i përgjithshëm strategjik i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve administrative sa më kualitative, të qasshme duke u bazuar në procedura administrative të arsyeshme të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.

Bazuar në planifikimin buxhetor dhe planifikim të prokurimit gjatë kësaj periudhe kohore janë proceduar projektet:

- Rimodelimi i sallës së takimeve;
- Ndarja fizike për qendrën për shërbime me qytetarë;
- Sistemi i zërimit për sallën e Kuvendit të komunës;
- Libërlidhja e akteve dhe dokumenteve të ndryshme;

Si dhe procedurat e rregullta për furnizime:

- Furnizim me pajisje të TI;
- Furnizim me inventar etj.

Pasqyra e të hyrave e Drejtorisë për Administratë për këtë periudhë

Të hyrat e drejtorisë

Të hyrat nga shërbimet administrative

15,222.00€

Drejtorinë për Administratë e përbëjnë këto njësi:

- Sektori i gjendjes civile;
- Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative;
- Qendra e shërbimeve për qytetarë;
- Njësi për të drejtave të njeriut;

Sektori i gjendjes civile

Shërbimi i Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-Qershor i ka pranuar mbi 28502 kërkesa të qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme dhe për të gjitha këto kërkesa zyra e gjendjes civile ka ofruar përgjigje dhe shërbime në mënyrë efektive dhe efikase duke vendosur për së cilën kërkesë veç e veç, trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive është në ngritje të vazhdueshme në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit, profesionalizmit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe procesit të digjitalizimit të regjistrave dhe dokumenteve të gjendjes civile dhe harmonizimit të procedurave në ofrimin e shërbimeve dhe të lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile.

Objektivat e sektorit të gjendjes civile për vitin 2024 kanë qenë:

1. Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit gjatë përditësimit të shënimeve dhe të dhënave personale të qytetarëve në Regjistrin Qendror Elektronik të gjendjes Civile dhe administrimi i regjistrave themeltar fizik.
2. Shqyrtimi i kërkesave në mënyrë të drejtë dhe nxjerrja e vendimeve për korrigjimin, ndërrimin dhe regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe fakteve të vdekjes.
3. Skanimit dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të fakteve të lindurve dhe të të vdekurve në regjistrat themeltar dhe në regjistrin qendror të gjendjes civile, shtypja dhe mbajtja e akteve në mënyrë korrekte dhe cilësore duke krijuar dosje për së cilën rast dhe arkivimi i tyre.
4. Skanimit dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të martesave brenda orarit të punës dhe regjistrimi i martesave jashtë selisë së komunës dhe jashtë orarit të punës, duke i shtypur dhe mbajtur aktet në mënyrë korrekte, cilësore dhe duke krijuar dosje për së cilën rast.
5. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të tjera të Gjendjes Civile, si dhe dhënia e shërbimeve të tjera në mënyrë efektive dhe pa gabime.
6. Azhurnimi i të gjitha kërkesave në intranet duke ju dhënë përgjigje dhe zgjidhje në mënyrë efektive dhe pa gabime.
7. Ndërlidhja dhe harmonizimi i të dhënave personale të gjendjes civile për të gjithë qytetarët ndërmjet regjistrit qendror elektronik të gjendjes civile me platformën(elektronike) online E-Kosova me qëllim që të krijohet mundësia e pajisjes(nxjerrjes) së certifikatave të gjendjes civile nga kjo platformë pa pasur nevojë që të kontaktohet zyra e gjendjes civile.
8. Ngritja e përgjegjësisë në ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale dhe komunikimi i tyre vetëm personave që i parasheh ligji.

Për realizimin e këtyre objektivave në mënyrë efektive dhe efikase janë caktuar dhe ndërmarrë 80 aktivitete dhe detyra.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat të qytetarëve dhe ju kemi dhënë përgjigje sipas afateve ligjore dhe janë dhënë shërbime efikase dhe efektive.

Më së miri punën e zyrës së gjendjes civile për periudhën janar-dhjetor e pasqyrojnë tabelat e poshtëshënuara, të cila tregojnë në tërësi punën që është bërë nga zyra e gjendjes civile në shërbim të qytetarëve duke i proceduar dhe realizuar kërkesat e palëve dhe duke bërë lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të tjera të gjendjes civile nga zyra e Gjendjes Civile për komunën e Vushtrisë.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa të tjera:

1.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes	1
2.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	11
2.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	13
3.	Vendime për korrigjime të të dhënave personale në RQ	30
4.	Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik	4
5.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	2
6.	Dëshmi të vdekjes	100
7.	Lajmërim dhe ç' lajmërim të adresës së vendbanimit	127
8.	Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes,	12
9.	Vendime për korrigjimin e Akteve të vdekjes	5
10.	Vendime për korrigjimin e Akteve të martesës	6
11.	Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë)	5
12.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	6
13.	Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës	10
14.	Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë	6
15.	Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë) si pjesëtar i diasporës	4
16.	Regjistrime në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile për herë të parë dhe gjenerimin e numrit personal	162
Gjithsej regjistrime të bëra		504

Numri i dokumenteve të lëshuara:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	12968
2.	Certifikata të lindjes	5400
3.	Certifikata të martesës	2498
4.	Certifikata të vdekjes	1428
5.	Certifikata të Statusit martesor	266
6.	Certifikata të shtetësisë	118
7.	Certifikata familjare	2775
8.	Certifikata të vendbanimit	1679
9.	Vërtetim nga arkivi	251
Gjithsej		27383

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes civile

1.	Regjistrime të lindjes	62
2.	Martesa	242
3.	Regjistrime të vdekjes	159
4.	Regjistrime të Shtetësisë	7
5.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	72
6.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	17
7.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	21
9.	Shkurorëzime	35
Gjithsejtë regjistrime të bëra		615

Ne këtë periudhë janë verifikuar **94** qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri me **19.02.2013** janë të verifikuar apo të regjistruar në sistemin e gjendjes civile **101614** qytetar të komunës së Vushtrrisë.

Zyra e gjendjes civile i ka marrë të gjitha masat që të zbatojmë vendimin e MAPL-së për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas të të gjitha fakteve të lindjes për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptas.

Edhe këtë vit kemi parapare që të fillojmë me shërbimin e veçantë për bashkatdhetarë gjatë muajve të verës, me ç'rast kemi caktuar 3 sportele të veçanta vetëm për bashkatdhetarët me qëllim të shërbimit sa më të mirë dhe më të shpejtë për mërgimtarët e komunës sonë, po ashtu me vendim të kryetarit të komunës Zyra e Gjendjes Civile ka filluar që të punojë edhe të shtunave duke filluar nga muaji qershor prej orës 10:00 deri në ora 14:00 .

Në vazhdim të ofrimit të shërbimeve më efektive dhe më efektive zyra e gjendjes civile duke u bazuar në rregulloren Nr. 09/2023 të datës 28.12.2023 i ka liruar nga pagesa të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për të gjitha llojet e certifikatave që lëshohen në zyrën e Gjendjes civile e që shërbejnë për përdorim brenda vendit, kjo gjë është arritur në bashkëpunim me kryetarin e komunës dhe në mbështetje të kuvendit komunal të cilët e kanë mbështetur dhe e kanë votuar këtë iniciativë të zyrës së gjendjes civile dhe të drejtorisë për administratë.

Duhet theksuar që gjatë kësaj periudhe është bërë auditimi i brendshëm , ku gjatë procesit të auditimit të rregullt më datë 20.02.2024, sipas këtij plani për auditimit të brendshëm kemi bashkëpunuar ngushtë me auditorët e brendshëm komunal dhe nga ky auditim kemi pasur një rezultat pozitiv dhe sipas raportit të auditimit nuk ka rezultuar asnjë e gjetur sa i përket këtyre lëndëve të zyrës së gjendjes civile.

Në këtë auditim janë përfshirë 15 lëndë për lëshimin e certifikatave dhe mënyrën e inkasimit dhe lirimit nga pagesa, si dhe është bërë auditimi për periudhën 0.10.2023 deri më 15.02.2024 për të gjitha kërkesat për ndërrimin e emrit personal, regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe të vdekjes për periudhën e lartcekur.

Spektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Spektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e sistemit të teknologjisë informative të komunës, lekturimi i materialeve të organeve të komunës dhe përkthimi i materialeve zyrtare të komunës nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas si dhe asistimi në përkthimin simulant për nevojat e organeve të komunës, mirëmbajtjen e të gjitha stabilimenteve elektrike dhe teknike në ambientet e objekteve të komunës, ndërrimi dhe riparimi i stabilimenteve, montimin e pjesëve të reja sipas nevojës së parashtruar si dhe të gjitha punët që kanë të bëjnë me logjistikë.

Aktiviteti i Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative ishte i përkushtuar në këto qëllimet kryesore:

1. Funkcionalitetit i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës
2. Monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale;
3. Integriteti dhe ruajtja e të dhënave;
4. Mbështetja lidhur me përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve të TI;
5. Menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta

Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative sipas planit vjetor ka pasur 5 objektiva të përcaktuar të përshkruara më lart, ku për arritjen e këtyre objektivave ka zhvilluar 15 aktivitete të tjera të paparapara sipas planit vjetor të veprimit. Të gjitha këto kanë dalë si rezultat i nevojave të Administratës në përmbushjen e obligimeve dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Përshkrimi i punëve, detyrave dhe intervenime të bëra	
Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e probleme softuerike.	63
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	168
Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme.	117
Postime në ueb faqe dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare	8
Lekturimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës si dhe konsultime për lekturim.	23
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simulantë sipas nevojës të organeve komunale	82
Riparime dhe punë të ndryshme për mirëmbajtje të objektit komunal.	163

Qendra e Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë

Qendra për shërbim të qytetarëve - QSHQ, është njësi organizative e cila operon si sektor i Drejtorisë së administratës. Aktiviteti i saj ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për qytetarët, bizneset dhe subjektet tjera të cilat i drejtohen organeve të Komunës me kërkesë për shërbime të caktuara.

Kjo qendër aktivitetin e vet e bazon kryesisht në pranimin e kërkesave nga qytetarët dhe shpërndarjen e atyre kërkesave nëpër drejtori – zyrat përkatëse si dhe pranimin e përgjigjeve (vendimeve) nga këto drejtori – zyra me qëllim të shpërndarjes së tyre deri tek qytetari i cili ka parashtruar kërkesë. Qendra gjithashtu ka për obligim që të mbaj evidencë, përcjell dhe në rastet kur afati i përgjigjes për ndonjë lëndë të caktuar i ofrohet skadimit, të intervenoj tek drejtorja-zyra së cilës i është adresuar lënda në mënyrë që përgjigja të kthehet brenda afatit të paraparë ligjor. Shërbimet të cilat i ofron QSHQ, janë shërbime ndërmjetësuese dhe përbëjnë këto:

- Pranimi elektronik i kërkesave
- Skanimi i kërkesave
- Protokolli elektronik
- Unifikimi i protokollit
- Procesimi elektronik i lëndëve
- Kthimi elektronik i përgjigjeve
- Tavolina informative, etj.

Tabela e mëposhtme përshkruan numrin e kërkesave të parashtruara në drejtoritë komunale të cilat janë pranuar nga zyrtaret e QSHQ-se,

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 27037 kërkesa, prej të cilave janë:

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave
1	Drejtoria për Administratë	17105
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	3148
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1058
4	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	704
5	Drejtoria për Shërbime Publike	363
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1199
7	Drejtoria për Arsim	489
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	277
9	Drejtoria për Inspeksion	225
10	Personeli	650
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	192
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	199
13	Zyra Ligjore	1204
14	Kryetari i Komunës	127
15	Drejtoria e Prokurimit	11
16	Kuvendi i Komunës	19
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	4
18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	2
19	Drejtoria Për Ekonomi dhe Investime Kapitale	61
20	Zyra për Integrime Evropiane	0
		27037

Njësiti Komunal për të Drejtat e Njeriut

Njësiti për të drejtave të njeriut koordinon, udhëheq dhe mbikëqyr politikat në komunë në fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë respektimin e politikave për barazinë gjinore, të drejtave të komuniteteve, përdorimin e gjuhëve, mundësitë e barabarta, zbatimin e politikave për personat me aftësi të kufizuar, të drejtave të fëmijëve kundër diskriminimit dhe antitrafikimit.

Bazuar në përgjegjësitë dhe planin e punës Njësiti për të drejtat e njeriut ka realizuar këto aktivitete:

- Përgatitja dhe dorëzimi i Planit të punës së NJKDNJ tek MAPL dhe ABGJ ;
- Dorëzimi i Raportit një vjeçar të punës te ABGJ – Agjensioni për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit;
- Dorëzimi i Planit të punës -2024- nga NJKDNJ te MAPL dhe ABGJ dhe ZKQM ;
- Pjesëmarrja në mbledhjen e KK Vushtrri;
- Pjesëmarrja në mbledhjen e KKSB;

- Pjesëmarrja në mbledhjen e KKRA;
- Plotësimi i pyetësorit nga ABGJ për çështjen gjinore;
- Organizimi i 17 shkurtit Dita e Pavarësisë vizitë shkollës Naim Frashëri;
- Organizimi i Ditës Ndërkombëtare të gruas 8 marsi, marshimi Stop dhunës ndaj gruas;
- Organizimi i tri tryezave të diskutimit; e para lidhur me sfidat e arsimit ndër vite, e dyta e drejta pronësore e grave, e treta Ndal dhunës ndaj gruas;
- Organizimi i 2 prillit Ditës Ndërkombëtare të autizmit;
- Përfundimi i aktivitetit me fëmijë Sondrom Daon vallëzimi me ngjyrat Ebre, këtë aktivitet e kemi realizuar me Institutin Jonuz Emre; dhe bizneset e komunës të cilët i blen piktura et fëmijëve;
- Takim me koordinatori i OJQ Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut;
- Plotësimi i tabelarit për raportimin për PAK, dërguar nga Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë;
- Pjesëmarrja në trajnimin organizuar nga USAID lidhur me Kodin e etikës;
- Pjesëmarrja në trajnim Hyrje në antigjyptizëm, organizuar nga ZKQM;
- Pjesëmarrja në orën e protestës kundër vrasjeve të grave nga burrat, organizuar nga SHMU2;
- Vizitë në Shtëpinë e komunitetit në Lumadh;
- Plotësimi i pyetësorit dërguar e Rrjetit të Grave të Kosovës lidhur me pozitën e gruas në viset rurale në komunën tonë;
- Pjesëmarrja në trajnim organizuar nga Asosacioni i Komunave; tema, mekanizmat për te drejtat e njeriut ne nivelin lokal;
- Raportimi për performancë nga fusha çështjet gjinore;
- Dërgimi i statistikave në ABGJ lidhur me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve;
- Dërgimi i statistikave te Zyra e kryeministrit për qeverisje të mirë, lidhur me Ligjin kundër Diskriminimit;
- Plotësimi i pyetësorëve që na janë dërguar nga ABGJ, MAPL;
- Takim në zyre me palët e komunitetit rom;
- Takim me Institutin Hasan Tahsim, lidhur me bashkëpunimin e përbashkët;
- Vizitë në 10 shkolla fillore në komunën e Vushtrisë;
- Organizimi i takimit me gratë kryefamiljare me temë të drejtat e tyre në pronësi;
- Pjesëmarrja në trajnim një ditor për raportimin për performancë;
- Pjesëmarrja në punëtori lidhur me dialogun rreth barazisë gjinore;
- Pjesëmarrja në punëtori lidhur me strategjinë për komunitetin rom;
- Pjesëmarrja në katër takime me gratë e Grupit Joformal që bashkëpunojnë me IADK;
- Pjesëmarrja në trajnim lidhur me raportimin për diskriminimin bazuar në Programin e Kosovës Kundër Diskriminimit;
- Pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare e Java e Gruas 2024;
- Pjesëmarrja në punëtori për plotësim ndryshim të e Rregullores për tarifa, gjoba e ngarkesa;
- Pjesëmarrja në disa takime me USAID, te Kontrata Sociale
- Dërgimi i raportimit te ZKQM, lidhur me raportimin për zbatimin e Kornizës së treguesve për të Drejta të Njeriut;
- Pjesëmarrja në punëtori për raportimin në baza gjinore;
- Vizitë në Hendikos;
- Vizitë Shoqatës “Martirët e Lirisë”;
- Organizimi i 1 qershorit Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve;



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opštine Vučitrn / Municipality Vushtrri



Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

DATË/A	07.06.2024
REFERENC-Ë	Nr. 238/2024
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politik dhe financa
PËRMES:	Kryetarit të komunës z. Ferit IDRIZI
NGA/OD/FROM:	Isa LATIFI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa Leje

I/e nderuar,

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranon kërkesat për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje dhe bënë shqyrtimin e kërkesave gjer ne vendosjen e tyre.

Drejtoria nga viti 2020 gjer në vitin 2024 i ka pranuar gjithsejtë **1360** kërkesa për legalizim të gjitha janë pranuar , regjistruar, protokolluar dhe sistemuar.

Vetëm gjatë vitit 2024 drejtoria i ka pranuar **33 kërkesa** për legalizim të objekteve pa leje.

Në këtë periudhe kohore Janar-Maj të vitit 2024 janë shqyrtua gjithsejtë **11 kërkesa** prej tyre janë 10 kërkesa të pranuar nga vitet e mëparshme 2020/2023 ndërsa 1 (Një) kërkesë është e shqyrtuar dhe pranuar gjate vitit 2024 për të gjitha kërkesat e shqyrtuara janë nxjerr Vendime për Certifikatën e Legalizimit.

Të gjitha **dosjet (11)**te cilat janë shqyrtua, i kanë plotësua kriteret për legalizim janë nxjerr Vendime për Certifikatën e Legalizimit janë dërgua në Kadastër për regjistrim në RDPP.

Gjatë periudhës kohore Janar –Maj 2024 gjithnjë me kërkesë të palës **17 dosje (kopje)** të legalizimit u janë dorëzua palëve pasi kanë sjellë dëshmitë nga kadastra se objekti i legalizuar është regjistrua në regjistrat kadastrale RDPP.

Në mungesë të stafit të pamjaftueshëm nuk mund të shqyrtohen të gjitha kërkesat brenda afatit ligjor pore, shqyrtohen vetëm kërkesat që palët i kërkojnë me urgjencë, të tjerat janë në pritje për shqyrtim.

Ju faleminderit për mirëkuptim.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

DATË /A:	06.06.2024
REFERENCË :	05Nr. <u>96</u> /24
PËR:	KK i Komunës së Vushtrrisë
CC:	Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave MPB, Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve
PËRMES:	z. Ferit Idrizi <i>Ferit Idrizi</i> Kryetari i Komunës së Vushtrrisë
NGA:	z. Agim Miftari <i>Agim Miftari</i> Sekretar dhe Kryesues i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera
TEMA:	Raport i vlerësimit të dëmeve nga FNFT

Në bazë të nenit 12.2, pika "d", të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 19, pika 1.4. si dhe nenet 4, pika 1,2,3 dhe neni 12, pika 1.5, bazuar në Rregullore (Qrk) Nr. 17/2015, për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera ka përgatitur këtë:

RAPORT I VLERËSIMIT TË DËMEVE NGA FATKEQËIT NATYRORE DHE FATKEQËSIT E TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRIË - PËR MUAJËT DHJETOR 2023 DHE MUAJËT JANAR, SHKURT, MARS DHE MAJ 2024

Dëmet në Bujqësi, dhjetor 2023

Më dt. 2 dhjetor 2023, nga një erë e fortë e cila ka përfshirë territorin e Vushtrrisë, ka shkaktuar dëme në bujqësi, kryesisht në sera. Nga kjo erë janë dëmtuar shumë sera me sipërfaqe më pak se 5 ari dhe një serë me sipërfaqe 20 ari. Kërkesa për vlerësimin e dëmeve në serra me sipërfaqe mbi 5 ari, të shkaktuara nga era, kanë parashtruar 1(një) qytetare.

Dëmet në Ekonomi, dhjetor 2023

Më dt. 2 dhjetor 2023, nga një erë e fortë e cila ka përfshirë territorin e Vushtrrisë, ka shkaktuar dëme në ekonomi, kryesisht në kulme të shtëpive dhe objekteve. Gjithsej kërkesa për dëme nga era kanë parashtruar 6(gjashtë) qytetar, kurse një qytetar kurse një qytetar ka parashtruar kërkesë se me datën 1 dhjetor 2023, nga zjarri i është djegur depoja dhe kuzhina verore.

Dëmet në ekonomi, janar 2024

Më dt. 12 janar 2024, një qytetar nga fshati Bajskë/K.Vushtrri, ka parashtruar kërkesë se me datën 11.01.2024, nga zjarri i është djegur objekti të cilin e ka shfrytëzuar për qeljen dhe rritjen e zogjve.

Dëmet në bujqësi, shkurt 2024

Me datën 9 shkurt 2024 - Nga era e fortë e cila ka përfshirë territorin e komunës sonë kemi pasur dëme në serra, ku kërkesa për kompensim të dëmit në serra me sipërfaqe mbi 5 ari ka parashtruar 1(një) qytetar. Me datën 12 shkurt 2024, një qytetar nga fshati Akrahticë/K.Vushtrri, ka parashtruar kërkesë se me datën 4 shkurt 2024, nga zjarri i janë djegur rreth 70 ari të mbjellura me lajthi.

Dëmet në bujqësi, mars 2024

Me datën 11 mars 2024 - Nga era e fortë e cila ka përfshirë një pjesë të territorit të komunës sonë kemi pasur dëme në serra, ku kërkesa për kompensim të dëmit në serra me sipërfaqe mbi 5 ari kanë parashtruar 2(dy) qytetar.

Dëmet në bujqësi, maj 2024

Më dt. 27 maj 2024, një qytetar nga Vushtrria, ka parashtruar kërkesë se gjatë natës qentë endacak i kishin ngrënë 400 pula. Pulat i ka patur të rrethuara me tel, por qentë e kanë dëmtuar rrethojën nga teli dhe janë futur brenda rrethojës.

Komisionet që kanë punuar në vlerësimin e dëmeve janë:

1. Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, i themeluar me vendimin 02/nr.1661/22, datë 19.12.2023, në këtë përbërje:

- 1. Agim Miftari ,Ing. i Xehetarisë-sekretar dhe kryesues i komisionit*
- 2. Avdyl Feka, Ing. i Bujqësisë - anëtar*
- 3. Egzon Haradinaj, Ing. i Arkitekturës - anëtar*
- 4. Betim Grabanica, Ekonomist- anëtar*
- 5. Fadil Selimi, Gjeodet - anëtar*

Raportit i bashkëngjisim edhe tabelat e vlerësimit të dëmeve në faqen 3 dhe 4 të këtij raporti

Tabela 1

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI, Periudha dhjetor 2023					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Antigona Salihu	Pantinë	sera -20 ari - folia	Era e fortë	2,960.00 €
					2,960.00 €

Tabela 2

DËMET NË EKONOMI - VUSHTRRI, Periudha dhjetor 2023					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Fahri Aliu	Vushtrri	Kulmi i objektit	Era e fortë	7,500.00 €
2	Emsale Zoni	Vushtrri	Oxhaku dhe kulmi i shtëpisë	Era e fortë	132.00 €
3	Salih Bajrami	Vushtrri	Depo dhe Kuzhina verore	Era e fortë	288.00 €
4	Fehmi Vatovci	Novolan	Kulmi në shtëpi banimi dhe depo	Era e fortë	1,620.00 €
5	Imer Mustafa	Reznik	Oxhaku dhe kulmi i shtëpisë	Era e fortë	109.50 €
6	Brahim Manovi	Duboc	Kulmi i objektit	Era e fortë	1,250.00 €
7	Fitim Ahmeti	Duboc	Depo dhe Kuzhina verore	Zjarri	3,682.00 €
					14,581.50 €

Tabela 3

LISTA E DËMTIMEVE NË EKONOMI - VUSHTRRI, Periudha janar 2024					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Brahim Uka	Bajskë	objekti për qeljen dhe ruajtjen e zogjëve	Zjarri	2,159.00 €

Tabela 4

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI, Periudha shkurt 2024					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Zenë Haradinaj	Stanoc i Epërm	sera -30 ari- folia	Era e fortë	4,440.00 €
2	Jeton Zeka	Akrashticë, nr.22	30 ari Lajthi	Zjarri	7,228.00 €
					11,668.00 €

Tabela 5

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI, Periudha mars 2024					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Anife Zhegrova	Stanoc i Poshtëm	Sera -Folia	Era e fortë	8,880.00 €
2	Agnesa Bajgora	Vushtrri	Sera -Folia	Era e fortë	832.50 €
					9,712.50 €

Tabela 6

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI, Periudha maj 2024					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Naim Sinani	Vushtrri	Pula	qent endacak	756.00 €

Dëmet e përgjithshme të shkaktuara nga era e fortë dhe zjarri

Nr. Ren	Përshkrimi i dëmit	Shuma e dëmit
1	Gjithsej dëme në bujqësi në muajin dhjetor 2023	2,960.00 €
2	Gjithsej dëme në ekonomi në muajin dhjetor 2023	14,581.50 €
3	Gjithsej dëme në bujqësi në muajt shkurt, mars dhe maj 2024	22,136.50 €
4	Gjithsej dëme në ekonomi në muajin janar 2024	2,159.00 €
Gjithsej dëme të shkaktuara nga era dhe zjarri në territorin e komunës së Vushtrrisë në muajin dhjetor 2023 dhe në muajt janar, shkurt, mars dhe maj 2024		41,837.00 €

Dëmet në territorin e Komunës së Vushtrrisë të shkaktuara nga FNFT –era e fortë dhe zjarri në muajt dhjetor 2023 dhe janar, shkurt, mars dhe maj 2024, kapin vlerën 41,837.00 €